



Genericon Pharma

# Pantoprazol

Pantoprazol "Genericon" Tableta gastro-rezistente 40 mg & 20 mg FORMA DHE PAKETIMI: Paketime origjinale në folie alumini me 14, tableta gastro-rezistente 40 mg, respektivisht 14, tableta gastro-rezistente 20 mg. SI VEPRON PANTOPRAZOL "GENERICON" Pantoprazoli është preparat nga grupi i benzimidazolit që inkibon sekretimin e acidit gastrik përmes veprimit specifik në pompën protonike të qelizave parietale të mukozës së lukthit. **INDIKACIONET:** Terapi e kombinuar me 2 antibiotikë adekuat për eradikimin (çrrënjosjen) e *Helicobacter pylori* dhe për parandalimin e relapsit (rikthimit) të ulçerës së lukthit te pacientët me ulçerë nga *H. Pylori*. Ulçera duodenale (zorrës dymbëdhjetëgjishore), Ulçera gastrike (lukthit), Format mesatare dhe të moderuara të reflux oesophagitis, Trajtimi afatgjatë i sindromit Zollinger-Ellison dhe çrregullimeve tjera të shoqëruara nga hipersekretimi (prodhimi i shtuar) patologjik i acidit gastrik. **KUNDËRINDIKACIONET:** Nëse jeni alergjik (hipersensitiv) ndaj substancës aktive ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të këtij bari, apo barnave tjera të kombinuara. Pantoprazoli sikur edhe barnat tjera nga grupi i inkibitorëve të pompës protonike nuk duhet përdorur në të njëjtën kohë me Atazanavir. **PËRKUJDESJET:** Te pacientët me çrregullime të rënda të funksionit të mëlçisë, doza duhet adaptuar (zvogëluar) konform gjendjes. Trajtimi me barna që zvogëlojnë aciditetin e lëngut të lukthit mund të rrisë lehtë rrezikun e infeksioneve gastro-intestinale, siç janë me *Salmonella* dhe *Campylobacter*. Deri më sot nuk ka të dhëna mbi efektin e barit te fëmijët nën 12 vjeç. **SHTATZËNIA DHE USHQYERJA ME GJI:** Përvoja klinike e përdorimit të Pantoprazolit në femra shtatzëna është e kufizuar. Në hulumtime reproduktive në shtazë eksperimentale janë raportuar shenja të lehta të fetotoksicitetit. Duhet kushtuar kujdes në rastet e përdorimit të pantoprazolit në gratë shtatzëna. Nuk ka të dhëna se pantoprazoli ekskretohet në qumështin e nënës. Gjatë periudhës së gjdhënjes, Pantoprazoli duhet përdoruar vetën nëse përfitim nga përdorimi për shëndetin e nënës e tejkalon rrezikun e mundshëm për fetusin përkatësisht foshnjën. **EFEKTET MBI AFTËSINË PËR TË DREJTUAR AUTOMJETIN DHE PËR TË PËRDORUR MAKINERIN:** Pantoprazol "Genericon" nuk ka ndikim në aftësinë për të drejtuar automjete dhe për të përdorur makineri. **NDËRVEPRIMET ME BARNAT TJERA:** Mundësia e ndërveprimeve me: etokonazol; itrakonazol; atazanavir; ritonavir; karbamazepinë; kafeinë; diazepam; diklofenak; digoksinë; etanol; glibenklamid; metoprolol; naproksen; nifedipinë; fenitoinë; piroksikam; teofilinë; kontraceptivë orale; fenprokumon ose varfarinë. **EFEKTET ANËSORE TË MUNDSHME:** Shumë Rrallë: leukopenia, trombocitopenia, reaksione anafilaktike duke përfshirë edhe shokun anafilaktik, depresioni, halucinacione, dezorientim dhe konfuzion, çrregullimi i funksionit të qelizave të mëlçisë, nefriti intestinal, gjinekonomia, edema periferike, altralgjia. **Efektet anësore tjera:** marramendja, çrregullime të të pamurit (të pamurit e turbulluar) ankesa të pjesës së sipërme të barkut, barkqitja, kapsllëku; flatuena (fryerja e barkut), etj. **MËNYRA E DHËNIES SË BARIT:** Bari jepet vetëm me recetë mjeku

Përfaqësues Ekskluziv për Kosovë:



Pharma  
plus

Pharmaplus  
Rr. "28 Nëntori"  
Qendra Tregtare te PTK  
Tel/Fax: 038 551 001  
Email: [pharmaplusllc@gmail.com](mailto:pharmaplusllc@gmail.com)





# Pantoprazol Genericon

## Forma farmaceutike dhe doza

Pantoprazol "Genericon" 40 mg tableta (1 x 14 tableta)  
Pantoprazol "Genericon" 20 mg tableta (1 x 14 tableta)


## Përparësitë klinike të përdorimit të Pantoprazol "Genericon"

- Pantoprazol "Genericon" mundëson kontrollë efektive në inkubim e sekretimit të lëngut gastric
- Pantoprazol "Genericon" manifeston ndërveprime minimale me barna tjera krahasuar me bllokatorët tjerë të pompës protonike
- Efekt të lartë gastroprotektiv gjatë terapisë me barna anti-inflamatorë josteroidë (AIJS) te pacientët me rrezik të lartë
- Pantoprazol "Genericon" disponon me profil të volitshëm farmakokinetik, pa ndikim në tretjen e ushqimit dhe në shkallën e absorbimit të tij
- Te të moshuarit nuk nevojitet adaptimi i dozës së barit Pantoprazol "Genericon".
- Te format mesatare dhe të rënda të insuficiencës së veshkave nuk nevojitet adaptimi i dozës.
- Bashkë-administrimi Pantoprazol "Genericon"+ Clopidogrel nuk shoqërohet me rritje të incidencës së re-infarktit të miokardit (ndërsa incidenca e infarktit është e rritur deri 40% gjatë bashkë-administrimit të Clopidogrel me Omeprazol, Lansoprazol dhe inhibitorët tjerë të pompës protonike).


## Indikacionet dhe dozimi me Pantoprazol-Genericon

Indikacionet	Doza fillestare	Doza e mbajtjes	Kohëzgjatja e trajtimit
Reflux esophagitis	1 x 40 mg	1-2 x 40 mg	10 ditë
Ulçera gastrike	1 x 40 mg	1 x 40 - 80 mg	4 - 8 javë
Ulçera duodenale	1 x 40 mg	1 x 40 - 80 mg	2 - 4 javë
Sindromi Zollinger-Ellison	1 x 80 mg	2 x 40 - 80 mg	Sipas indikacioneve
Eradikimi i H. Pylori (terapi e kombinuar)	2 x 40 mg	2 x 40 mg	7 - 14 ditë
Refluksi laringofaringeal	1 x 40 mg	1-2 x 40 mg	3 muaj
Profilaksa e mukozës së TGI gjatë terapisë me barna AIJS	1 x 20 - 40 mg	1 x 40 mg	Sipas indikacioneve


## Profil i ndërveprimeve me barna



Profil i volitshëm i ndërveprimit me barna tjera qëndron në faktin se Pantoprazol nuk inkubon sistemin enzimatik CYP 450 2C19 të mëljçisë



Përdorimi i Clopidogrelit me inhibitorë të pompës protonike me përjashtim të Pantoprazol rritet rrezikun për infarkt miokardi për 40%.



Pantoprazol "Genericon" është dukshëm me efikas krahasuar me barnat tjera nga grupi i bllokatorëve të pompës protonike në zvogëlimin e dispepsisë gjatë terapisë me barna AIJS. Spiegel et al. Am J Med 2006;119:448.e27-448.e36

Efikasiteti në profilaksën e "Stress ulçerës" është në mënyrë evidente më i shprehur te Pantoprazol "Genericon" krahasuar me barna tjera nga grupi i bllokatorëve të pompës protonike. Brett S. Critical Care 2005; 9:45-50.

## Përfundimet e arta për Pantoprazol "Genericon"

- Pantoprazol "Genericon" konsiderohet bar i rendit të parë të rastet e terapisë së kombinuar të inhibitorëve të pompës protonike me Clopidogrel
- Pantoprazol "Genericon" redukton frekuencën dhe intezitetin e efekteve anësore gastroduodenale te pacientët që marrin terapi me barna AIJS.
- Pantoprazol "Genericon" ka shkallë të ultë të interveksionit me barna tjera krahasuar me preparatet tjera nga grupi i bllokatorëve të pompës protonike.
- Pantoprazol "Genericon" ka profil të volitshëm të sigurisë (efekte anësore të rralla)

Suksesi i mjekimit të ulçerës gastroduodenale me Pantoprazol "Genericon" arrihet më shpejt krahasuar me Omeprazol dhe Misoprostol.